

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në përbushje të misionit të tij për dhënien e informacionit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në mënyrë që të edukojë publikun e të mbështesë vlerat demokratike të drejtësisë, të vërtetën, pajtimin e përgjegjësinë për brezat e ardhshëm;

Duke konsideruar se veprimtaria e Autoritetit është udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, mbrojtjes së të dhënave personale, dhënies së informacionit publikut, institucioneve dhe medias në kohë dhe me cilësi;

Duke vlerësuar bashkëpunimin e Autoritetit me institucione të tjera vendase dhe institucione homologe ndërkombëtare për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së Autoritetit;

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2025, në drejtim të:

Avancimit të procesit të identifikimit të personave të zhdukur gjatë diktaturës përmes hetimeve administrative, verifikimeve në terren dhe bashkëpunimit me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), duke sjellë progres konkret në evidentimin e vendvarrimeve të dyshuara dhe konfirmimin shkencor të rasteve me interes hetimor.

Finalizimit të sistemit të databazës kombëtare për personat e zhdukur dhe integritetit të të dhënave të mbledhura për periudhën 2017–2025.

Intensifikimit të punës ndërgjegjëse me pushtetin vendor, me qëllim zbatimin korrekt të ligjit për kryerjen e procesit të verifikimit të figurës së personave që propozohen për dekorim, tituj nderi apo propozimeve për emërtimin e hapësirave publike me emra personalitetesh.

Intensifikimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për marrjen në administrim të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit.

Zhvillimin e një programi aktiviteteve edukative, ndërgjegjëse dhe përkujtimore në bashkëpunim me institucionet partnere, me fokus edukimin qytetar, kujtesën historike dhe promovimin e vlerave demokratike.

Rritjen e konsiderueshme të volumit të dokumenteve të trajtuara për qëllime studimore dhe mediatike.

Kuvendi rekomandon që Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për vitin 2026:

1. Të kryejë një analizë krahasuese të kuadrit ligjor dhe institucional të vendeve që kanë kaluar përvoja historike të ngjashme me Shqipërinë, me qëllim identifikimin e praktikave më të mira për gjetjen, identifikimin dhe dokumentimin e rasteve të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist, si dhe t'i paraqesë Kuvendit gjetjet dhe rekomandimet përkatëse për ndërmarrjen e nismave ligjore dhe institucionale.

2. Të vijojë procesin e verifikimeve administrative dhe bashkëpunimin ndërinstitucional për identifikimin, evidentimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e vendvarrimeve të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist, duke vënë në dispozicion dokumentacionin arkivor dhe ekspertizën institucionale për zbardhjen e fatit të viktimave dhe informimin e familjarëve të tyre.

3. Të përfundojë marrëveshjen e bashkëpunimit me ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, me qëllim garantimin e zbatimit të njëtrajtshëm dhe efektiv të legjislacionit në fuqi për verifikimin e figurës së personave që propozohen për dekorata, tituj nderi, emërtimin e hapësirave publike apo forma të tjera të vlerësimit publik.

4. Të intensifikojë procesin e digjitalizimit të fondit arkivor, duke hartuar dhe zbatuar një plan veprimi me objektiva të matshëm dhe afate të qarta, si dhe të zgjerojë aksesin publik në

dokumentacionin arkivor përmes platformave elektronike, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Të forcojë mekanizmat e bashkëpunimit institucional me partitë politike dhe subjektet zgjedhore, si dhe të ndërmarrë hapa proaktivë për garantimin e informacionit të nevojshëm në funksion të verifikimit të pastërtisë së figurës së kandidatëve në zgjedhjet parlamentare dhe vendore.

6. Të përmirësojë menaxhimin e fluksit të kërkesave dhe kapacitetet administrative e operacionale, me qëllim reduktimin e afateve të shqyrtimit, rritjen e cilësisë së shërbimit dhe garantimin e aksesit sa më efektiv të qytetarëve në dokumentacionin arkivor.

7. Të forcojë bashkëpunimin me institucionet homologe të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore që administrojnë arkivat e ish-shërbimeve të sigurisë, me qëllim shkëmbimin e praktikave më të mira, zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe rritjen e kapaciteteve institucionale.

8. Të zhvillojë programe edukimi dhe ndërgjegjësimi për të rinjtë dhe publikun e gjerë në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe kulturore, duke përdorur dokumente autentike arkivore për promovimin e kujtesës historike, të drejtave të njeriut dhe vlerave demokratike.

9. Të hartojë tregues të matshëm të performancës për veprimtarinë institucionale dhe të raportojë periodikisht mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit, me qëllim rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit të veprimtarisë së Autoritetit.

10. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit në funksion të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky angazhim të përmbushet brenda tremujorit të tretë të këtij viti.

Miratuar në datën 30.6.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi